



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:281203

Datë: 25.11.2020

Numri i dokumentit: 01296450

**C. nr. 1021/19**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil** me gjyqtaren Afijete Sada Glllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të paditësit Xh. N. nga fshati . . ., komuna e Gjakovës, përfaqësuar nga Dardan Morina avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria Komunale e Arsimit, kontest pune - kompensim të ushqimit gjatë punës, vlera kontestit 918.00€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 12 nëntor 2020, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të paditurës, përpiluar me datë 25 nëntor 2020, murr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit Xh. N. nga fshati . . ., komuna e Gjakovës dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Gjakovës- Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit të i paguajë në emër të kompensimit për ushqim për një ditë pune për periudhën kohore nga 18 prill 2017 e deri me datë 31 dhjetor 2019, dhe atë për 459 ditë pune nga 2(dy) euro, shumën 918.00€ (nëntëqind e tetëmbëdhjetë euro) me kamatë ligjore 8% nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe të ia kompensoj shpenzimet procedurale në shumë 395.00€, brenda afatit prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

**A r s y e t i m**

Paditësi me padi dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të tij ka parashtruar se është në marrëdhënie pune si mësimdhënës në SH.F.M.U “ Dëshmorët Lleshi ” në fshatin . . ., komuna e Gjakovës, ku i njëjti ka punuar dhe vazhdon të punoj në atë institucion, e që duke e llogaritur këtë periudhë kohore paditësit i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune në shumën prej 2(dy) euro në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të datës 18 prill 2017.

Paditësi duke marr parasysh kohen e nënshkrimi të kontratës së lartë cekur dhe të drejtave të cilat i njihen në atë kontratë punëtorëve të arsimit, ku ndër të tjera theksoj të drejtën e kompensimit për ushqim gjatë punës, të cilën të drejtë e përcakton neni 35 paragrafi 7 i cili thotë : citim” Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”, por kjo e drejtë nuk iu ka njohur asnjëherë prej ditës së nënshkrimit- hyrjes në fuqi të kësaj

kontrate me datë 18 prill 2017, deri në momentin e parashtrimit të padisë nga institucioni përkatës Drejtoria Komunale Arsimit të Gjakovës.

Me qëllim të realizimit të kësaj të drejte dhe shterjes së mjeteve në procedurë administrative, paditësi fillimisht iu ka drejtuar organit kompetent, këtu të paditurës me kërkesën për kompensimin e shumës së pa paguar –shujtave për periudhën kohore prej hyrjes në fuqi të kësaj kontrate e deri në momentin e parashtrimit të kërkesës.

Gjatë shqyrtimit i autorizuari i paditësit ka deklaruar se baza juridike e padisë nuk është kontestsuese për faktin se është në marrëdhënie të rregullt dhe me normë të plotë të punës tek e paditura, fakt i provuar nga vërtetimi i Shkollës ku ka punuar paditësi për periudhën kohore 18 prill 2017 deri me 31 dhjetor 2019. Paditësi ka gjithsejtë 459 ditë pune e që duhet të jetë 918.00€, obligim i pa përmbushur nga Drejtoria Komunale e Arsimit me kamatë ligjore nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën përfundimtare. Sa i përket përgjigjes në padi të njëjtën e ka kundërshtuar dhe konsideron që faktet dhe pretendimet të cilat janë theksuar në përgjigje në padi nuk qëndrojnë si të tilla.

Propozoj që kërkesëpadia e saktësuar të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet procedurale u kërkuan për taksë gjyqësore në shumë 21.00€, për përpilim të padisë 104.00€, për përfaqësim në dy seanca nga 135.00€, gjithsejtë shumën 395.00€.

E paditura ka paraqit përgjigje në padi jashtë afatit ligjor. Me te ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar dhe ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar me datë 18 prill 2017 në mes të Arsim Bajrami ish Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Rrahman Jashari, Kryetar i SBASHK-ut njoftojnë se përkundër nenit 46 të asaj Kontrate, nga ana e MASHT-it dhe SBASHK-ut nuk janë angazhuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston buxhetore për zbatimin e kësaj Kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit.

Po ashtu në bazë të Qarkores Buxhetore 2020/01, numër 777 datë 15 maj 2019 të lëshuar nga Bedri Hamza ish Ministër i Financave në Grantin Specifik për Arsim Parauniversitar ku vetëm është paraparë në pikën q) kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto 1.4 milion euro dhe nuk është paraparë kurrfarë obligimi për shpenzimet e shujtës ditore për punonjësit arsimor gjë që i bie e pa implementueshme në aspektin financiar për realizimin e kërkesëpadisë së paditësit në rastin konkret si dhe me dispozitën kalimtare të nenit 46 paragrafi 1 të Kontratës Kolektive të saj: “ MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për të informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 dhe nenin 46 paragrafi 2 ku MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenet 35 paragrafi 5,7 dhe 9 brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare”. Kërkesa e paditësit nuk ka qenë e paraparë edhe me Qarkoren 2017/01 datë 13 maj 2016, numër 966 e ish Ministrit të Financave Avdullah Hoti ku ndër të tjera Grantin Specifik për Arsimin Parauniversitar për vitin 2017 nuk është paraparë kurrëfarë obligimi për shpenzimet e shujtës ditore për punonjësit arsimor. Po ashtu edhe në Qarkoren buxhetore 2019/01 datë 15 maj 2018 numër 950 lëshuar nga Bedri Hamza ish Ministër i Financave ka qenë e paraparë pika q) kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto 1 milion euro. Bazuar

në Qarkoret e lartë shënuara nuk është paraparë implementimi i nenit 35 paragrafi 5 dhe 7 i Kontratës Kolektive.

Shqyrtimin kryesor të treguar me datë 12 nëntor 2020 Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt dhe me propozimin e të autorizuarit të paditësit, sipas nenit 423.4 të LPK-së.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave: si Kontratës së Punës të datës 01 shtator 2015, përgjigja në kërkesën për kompensimin e shujtave datë 02 dhjetor 2019, referenca 04-120/01-42023, vërtetimeve të SHFMU "Dëshmorët Lleshi" datë 31 tetor 2019 dhe 02 shtator 2020, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesëpadia e saktësuar është e bazuar dhe u aprovua.

Nga Kontrata e Punës vërtetohet se paditësi në cilësi të mësimdhënësit të lëndës së gjuhës angleze në Shkollën "Dëshmorët Lleshi" në fshatin . . . , komuna e Gjakovës ka lidhur kontratë pune me të paditurën në cilësi të punëdhënëses me datë 01 shtator 2015, në kohë zgjatje të përhershme me 40 orë mësimore në javë.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur kërkesë me datë 11 nëntor 2019 tek e paditura për kompensimin e shumës së pa paguar të shujtave –ushqimit gjatë ditëve të punës. Paditësi me përgjigjen në kërkesë me datë 02 dhjetor 2019, referenca 04-120/02-42023/19 duke njoftuar se: bazuar në Qarkoren Buxhetore 2019/1 dhe Qarkoren Buxhetore 2020/01 të Ministrisë së Financave të Kosovës për Grantin Specifik të Arsimit nuk është planifikuar buxheti për pagesën e kërkuar. Gjer me tani MASHT-it dhe SBASHK-ut nuk janë angazhuar bashkërisht që të informoj dhe ndihmojë komunat që të bëjnë ato planifikimet me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të datës 18 prill 2017 citim "Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim" andaj lidhur me këto si MASHT-i po ashtu edhe SBASHK-u nuk janë angazhuar që bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 37 paragrafi 7 brenda mundësive financiare, institucionale, ligjore.

Sipas vërtetimeve të SHFMU "Dëshmorët Lleshi" . . . nr. 166 datë 31 tetor 2019 dhe nr.33 /2020 datë 02 shtator 2020 vërtetohet se paditësi ka punuar në atë institucion nga data 03 shtator 2008 dhe ende vazhdon të punoj pranë asaj Shkolle. Ditët e prezencës në punë të paditësit nga data 18 prill 2017 deri me 31 dhjetor 2019 gjithsejtë janë 459 ditë pune.

Prej datës 18 prill 2017 deri me 31 dhjetor 2017 ka 124 ditë pune,  
Prej datës 01 janar 2018 deri me 31 dhjetor 2018 ka 165 ditë pune dhe prej datës 01 janar 2019 deri me 31 dhjetor 2019 ka 170 ditë pune.

Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e cila është e zbatueshme nga data 18 prill 2017 me nenin 35.7 përcakton se "Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë,

për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”.

Paditësi për periudhën 18 prill 2017 deri me datë 31 dhjetor 2019 ka gjithsejtë 459 ditë të pranisë në punë, për këtë i takon nga 2.00€ në ditë, gjithsejtë shuma 918.00 €.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysht edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. Sipas neneve të lartë cituara është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e ushqimit, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësës të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se “ debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën e që lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Paditësi i takon kamata e kërkuar nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi për shkak të rënies në vonesë të paditurës për përmbushjen e detyrimit të saj sa i përket ushqimit të kërkuar.

Me rastin e vendosjes Gjykata murr parasysht pretendimet e palës së paditur paraqitur në përgjigje në padi, por u konsideruan pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje. Lidhur me mos koordinimin institucional, siç janë Qarkoret e përmendura të Ministrive përkatëse pala paditëse nuk mund të pësoj nga fakti se Kontrata Kolektive kanë qenë në fuqi dhe e zbatueshme.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA ku paditësi i ka njohur të drejtën e shpenzimeve procedurale për taksë gjyqësore shumën 21.00 €, për përpilim të padisë shumën 104.00€, përfaqësim në dy seanca 135.20€, gjithsejtë shumën 395.00€.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr. 1021/19, datë 25 nëntor 2020**

**G j y q t a r j a,**  
**Afijete Sada Gllogjani**

**UDHËZIM JURIDIK;** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:281203  
Datë: 25.11.2020  
Numri i dokumentit: 01296450